

VENDIM
Nr. 293 , datë 5.4.2017

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.484, DATË 10.6.2015, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E
PUNËVE TË BRENDSHME DHE DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE TE
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE
PERSONALE, KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL DHE
AVOKATURA E SHTETIT, TË MJEDISEVE NË GODINËN E ISH – HOTEL “DRINIT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në fund të pikës 2, të vendimit nr.484, datë 10.6.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Kati i parë në pjesën e godinës 5-katëshe, sipas planimetrisë që i bashkëlidhet këtij vendimi, kalon në përgjegjësi administrimi të përbashkët të institucioneve të përmendura në pikën 1, të këtij vendimi, për t’u përdorur si qendër/sallë multifunksionale.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

PLANIMETRIJA E KATIT PERDHE SHK. 1:50



